



**BASHKIA TIRANË  
KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

Nr. 6 datë 12.02.2015

**PËR**

**“MIRATIMIN E DHËNIES SË AMBIENTIT NË PËRDORIM ORGANIZATËS SHOQËRORE TË PÛRKRAHJES SË TË RINJVE - ARSIS, ME DESTINACION PËR QENDËR SOCIALE, NË ZBATIM TË PROJEKTIT “QENDËR E QËNDRUESHME SHUMËDISIPLINARE NË NJËSINË BASHKIAKE NR. 7””.**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 10, pika 3/II, shkronja “c”, nenit 32, shkronja “e” dhe nenit 33, pika 4 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), nenit 901 e në vijim të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr.350, datë 10.8.1992 për “Mënyrën e klasifikimit të ndërmarrjeve shtetërore në kombëtare ose lokale”; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 143, datë 18.01.2012 “Për miratimin e listës paraprake (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tiranë, të Qarkut të Tiranës”; vendimit të Këshillit Bashkik nr.69, datë 20.12.2005 për “Miratimin e listës së pjesshme të inventarit të pronave të paluajtshme të cilat janë në territorin nën juridiksionin e Bashkisë së Tiranës”; vendimit të Këshillit Bashkiak nr.46, datë 28.07.2007 për “Miratimin e listës paraprake e pronave të paluajtshme shtetërore për të cilat Bashkia e Tiranës kërkon transferimin në pronësi të saj” dhe të vendimit nr. 20, datë 29.05.2014 i Këshillit Drejtues të Oficinës së Automjeteve, Tiranë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshillit Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë dhënie në përdorim pa kundërshpërblim për Organizatën Shoqërore të Përkrahjes së të Rinjve - ARSIS, për periudhën qershor 2014 - dhjetor 2015, të ambientit me Sipërfaqe të truallit Str=1280.0 m<sup>2</sup> dhe Sipërfaqe ndërtimi Snd. = 633.6 m<sup>2</sup> të Ndërmarrjes Ofiçina e Automjeteve të Transportit Nd.Sh.a (sipas gjenplanit bashkëngjitur).
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Financës, Drejtoria e Menaxhimit të Strehimit dhe Shërbimeve Sociale dhe Ndërmarrja Ofiçina e Automjeteve të Transportit Nd.Sh.a.

**3.** Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R**

**ALDRIN DALIPI**